



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27 Janar 2022

Nr: 24

VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE
NDËRGJEGJËSIMIT TË ZGJEDHËSVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE
PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pikat 1, shkronja “g”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N

Referuar nenit 19, pikat 1, shkronja “g”, e 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kujdeset për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve.

Programi për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, përcakton qëllimin, objektivat të cilat do të realizohen përmes projekteve të përgjithshme që do të adresojnë zgjedhësit e bashkive ku do të mbahen zgjedhjet e pjesshme, dhe projektet për grupime shoqërore të caktuara, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë. Për realizimin e projekteve, përcaktimi i mënyrave dhe mjeteve synon që çdo zgjedhës të mirëinformohet për procesin zgjedhor, të drejtat dhe detyrat e tij, të forcojë besimin në votën e lirë dhe të pandikuar.

Programi përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave, gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për



edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garantues për arritjen e standardeve të synuara.

Zbatimi i programeve të ndryshme për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në një periudhë të përcaktuar kohe është një proces kompleks, suksesi i të cilit ndërvarret edhe nga bashkëpunimi me aktorë të tjerë që kanë interes dhe mund të kontribuojnë.

Programi për edukimin e shtetasve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “g”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të miratojë programin për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga publikimi në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Komisioni
Qendror
i Zgjedhjeve

PROGRAMI PËR EDUKIMIN, INFORMIMIN DHE SENSIBILIZIMIN E ZGJEDHËSVE



ZGJEDHJET E PJESSHME NË 6 BASHKI

06 MARS 2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Përmbledhje Ekzekutive	3
Qëllimi i Programit	3
Objektivat kryesorë të programit janë:	3
PJESA E PARË	4
Informimi dhe sensibilizimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.	4
A. Media sociale	4
PJESA E DYTË.....	5
Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit.	5
A. Spotet Televizive.....	5
B. Media sociale	5
C. Materiale Promocionale	6
PJESA E TRETË	6
Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit.	6
A. Spotet Televizive.....	6
B. Media sociale	7
C. Materiale Promocionale	7
PJESA E KATËRT	7
Sensibilizimi i grave dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje;.....	7
A. Media sociale	7
PJESA E PESTË.....	8
Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre.	8
A. Spotet Televizive.....	8
B. Media sociale	8
C. Materiale Promocionale	9
PJESA E GJASHTË	9
Thirrje për pjesëmarrje në votime në bashkitë ku do të mbahen zgjedhjet e pjesshme.	9
A. Spotet Televizive.....	9
B. Spote Radiofonike.....	9
C. Media sociale	10
D. Materiale Promocionale	10

Përmbledhje Ekzekutive

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për Zgjedhjet e pjesshme që do të organizohen në gjashtë (6) bashki më 6 mars 2022 në Bashkia Shkodër, Bashkia Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Vorë, Bashkia Rrogozhinë, Bashkia Lushnjë, është një plan i cili përcakton qëllimet dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe sensibilizimin e zgjedhësve përgjatë periudhës zgjedhore.

Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave, gjithashtu reflekton punën dhe angazhimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin zgjedhor të shtetasve, në përmbushje të detyrës institucionale për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuar, ku edukimi dhe informimi i zgjedhësve është ndër komponentët kryesorë garantues për arritjen e standarteve të synuara.

Programi për edukimin e shtetasve për zgjedhjet e pjesshme më datë 06 mars 2022, synon sensibilizimi për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor.

Programet informuese do të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit të KQZ-së me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë.

Qëllimi i Programit

Programi për edukimin zgjedhor të shtetasve për zgjedhjet e pjesshme më datë 06 mars 2022, ka për qëllim të informojë dhe sensibilizojë zgjedhësit mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. Në mënyrë specifike programi ka si qëllim informimin dhe sensibilizimin e shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit elektronik; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi mënyrën e votimit dhe plotësimin korrekt të fletës së votimit; sensibilizimin dhe edukimin e grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje si dhe informimin i zgjedhësve mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor dhe i subjekteve zgjedhore, parandalimi i tyre.

Objektivat kryesore të programit janë:

1. Informimi dhe sensibilizimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit;
2. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit;
3. Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit;
4. Sensibilizimi i grave dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje;
5. Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre;
6. Thirrje për pjesëmarrje në votime në bashkitë ku do të mbahen zgjedhjet e pjesshme.

Të gjitha materialet që do të përdoren për sensibilizimin e zgjedhësve do të përkthehen në gjuhën e pakicave kombëtare bazuar në Ligjin Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë” neni 15, paragrafi 4.

Buxheti

Buxheti për zhvillimin e aktiviteteve për edukimin e zgjedhësve është parashikuar nga buxheti i shtetit për zgjedhjet gjithashtu edhe mbështetja nga partnerët vendas dhe të huaj.

PJESA E PARË

Informimi dhe sensibilizimi i shtetasve mbi listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit.

1) Qëllimi

Informimi dhe sensibilizimi i zgjedhësve për verifikimin e emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku ata do të votojnë. Veprimet që do të ndjekin zgjedhësit nëse vërejnë pasaktësi, nuk gjejnë emrin në listën e zgjedhësve, zgjedhësit duhet ti drejtohen me një kërkesë zyrës së Gjendjes Civile, që ndodhet brenda njësisë administrative ku ata banojnë.

2) Mjetet:

A. Media sociale

Periudha e transmetimit

Shkurt-Mars

A. Media sociale

Përmbajtja

Banerat që do të publikohen në mediat sociale, për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve dhe hapat që duhet të ndjekin për çdo pasaktësi do të qëndrojnë dhe do të shpërndahen për një kohë më të gjatë dhe me informacion të detajuar.

Periudha e publikimit:

Shkurt-Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!



PJESA E DYTË

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit në procesin e votimit.

1) Qëllimi:

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi procedurat e identifikimit elektronik ditën e zgjedhjeve. Ky proces nënkupton hapat që zgjedhësit duhet të ndjekin për të kryer identifikimin elektronik në aparaturën e vendosur për këtë qëllim në Qendrën e Votimit. Për këtë ka rendësi të veçantë vlefshmëria dhe gjendja fizike e dokumentit të identifikimit.

2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Media sociale
- C. Materiale promocionale

A. Spotet Televizive

Përmbajtja

Spoti televiziv do të përmbajë hapat që zgjedhësit duhet të ndjekin për të kryer identifikimin elektronik në aparaturën e vendosur për këtë qëllim në Qendrën e Votimit. Informacioni që do të përcillet do të shoqërohet edhe me imazhe.

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

Periudha e transmetimit

Shkurt-Mars

TV ku do të transmetohet

Në të gjitha tv e licensuar nga AMA (kombëtare apo lokale) dhe media sociale.

B. Media sociale

Përmbajtja

Banerat/ Spote që do të publikohen në mediat online do të përmbajnë informacion të detajuar mbi hapat që zgjedhësit duhet të ndjekin për të kryer identifikimin elektronik në aparaturën e vendosur për këtë qëllim në Qendrën e Votimit.

Periudha e publikimit:

Shkurt - Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!



C. Materiale Promocionale

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

Postera (formate të ndryshme) dhe City light.

Përmbajtja

Materialet promocionale do të përmbajnë informacion të detajuar mbi hapat që zgjedhësit duhet të ndjekin për të kryer identifikimin elektronik në aparaturën e vendosur për këtë qëllim në Qendrën e Votimit, shoqëruar me imazhe sipas llojit të përcaktuar.

PJESA E TRETË

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit.

1) Qëllimi:

Informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj. Zgjedhësit të jenë të përgatitur ditën e votimit për plotësimin e fletës së votimit që vota e tyre të jetë e vlefshme.

2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Media sociale
- C. Materiale promocionale

A. Spotet Televizive

Përmbajtja

Spotet televizive do të përmbajnë informacion mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj, çdo veprim i shoqëruar edhe me imazhe.

Kohëzgjatja e spotit 40-45 sekonda.

Periudha e transmetimit

Shkurt-Mars

TV ku do të transmetohet

Në të gjitha tv e liçensuar nga AMA (kombëtare apo lokale) dhe media sociale.

B. Media sociale

Përmbajtja

Banera/Spotet do të përmbajnë informacion mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj, çdo veprim i shoqëruar edhe me imazhe.

Periudha e publikimit;

Shkurt-Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!

C. Materiale Promocionale

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

Postera (formate të ndryshme)

Përmbajtja

Posterat do të përmbajnë informacion mbi mënyrën e votimit, përmbajtja e fletës së votimit dhe shënimin korrekt të saj, çdo veprim i shoqëruar edhe me imazhe sipas llojit të përcaktuar.

PJESA E KATËRT

Sensibilizimi i grave dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje;

1) Qëllimi:

Sensibilizimi i grupeve vulnerabël dhe të rinjve votues për herë të parë për pjesëmarrje. Ky program ka në fokus sensibilizimin e zgjedhëseve gra për të shmangur fenomenin negativ të ndikimit familjar në ushtrimin e të drejtës së tyre për të votuar dhe të pandikuar, si dhe votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi ndryshe, për pjesëmarrje në zgjedhjet e pjesshme në 6 bashki më 6 mars 2022.

2) Mjetet:

A. Media sociale

A. Media sociale

Përmbajtja

Banera/ Spot për të rinjtë votues për here të pare

Banera/ Spoti për pjesëmarrjen e grave në votime, kundër ndikimit familjarë

Periudha e publikimit;

Shkurt-Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!

PJESA E PESTË

Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor, parandalimi i tyre.

1) Qëllimi:

Sensibilizimin i zgjedhësve dhe subjekteve zgjedhore për rëndësinë e procesit zgjedhor, zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të pandikuara. Informimi i zgjedhësve dhe i subjekteve zgjedhore mbi shkeljet dhe veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit zgjedhor si dhe parandalimi i tyre.

2) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Media sociale
- C. Materiale promocionale

A. Spotet Televizive

Përmbajtja

Spotet televizive do të përmbajnë informacion mbi veprat penale që çenojnë mbarëvajtjen e zgjedhjeve, shoqëruar me imazhe.

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

Periudha e transmetimit

Shkurt-Mars

TV ku do të transmetohet

Në të gjitha tv e licensuar nga AMA (kombëtare apo lokale) dhe media sociale.

B. Media sociale

Përmbajtja

Banerat/ Spotet do të përmbajnë informacion mbi veprat penale që çenojnë mbarëvajtjen e zgjedhjeve, shoqëruar me imazhe.

Periudha e publikimit;

Shkurt-Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!



C. Materiale Promocionale

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

Postera (formate të ndryshme)

Përmbajtja

Posterat do të përmbajnë informacion mbi veprat penale që çenojnë mbarvajtjen e zgjedhjeve, shoqëruar me imazhe sipas llojit të përcaktuar.

PJESA E GJASHTË

Thirrje për pjesëmarrje në votime në bashkitë ku do të mbahen zgjedhjet e pjeshme.

3) Qëllimi:

Sensibilizimin i zgjedhësve, rritja e pjesëmarrjes së tyre në votime.

4) Mjetet:

- A. Spote televizive
- B. Spote radiofonike
- C. Media sociale
- D. Materiale promocionale

A. Spotet Televizive

Përmbajtja

Spotet televizive do të përmbajë informacion thirrje për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kryetar Bashkie në ato bashki ku do të mbahen zgjedhjet e pjeshme.

Kohëzgjatja e spotit 45 sekonda.

Periudha e transmetimit

Shkurt-Mars

TV ku do të transmetohet

Në të gjitha tv e licensuar nga AMA (kombëtare apo lokale) dhe media sociale.

B. Spote Radiofonike

Përmbajtja

Spoti radiofonik do të përmbajë informacion thirrje për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kryetar Bashkie në ato bashki ku do të mbahen zgjedhjet e pjeshme.

Kohëzgjatja e spotit 30 sekonda



Periudha e transmetimit:

Shkurt-Mars

Radio ku do të transmetohet:

Në radiot e licencuar nga AMA (kombëtare apo lokale)

C. Media sociale

Përmbajtja

Banerat/ Spotet do të përmbajnë informacion thirrje për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kryetar Bashkie në ato bashki ku do të mbahen zgjedhjet e pjesshme.

Periudha e publikimit:

Shkurt-Mars

Media sociale ku do të publikohen

Në mediat sociale të KQZ-së!

D. Materiale Promocionale

Lloji i materialeve promocionale që të përdoren:

Billboard/ City light (formate të ndryshme)

Përmbajtja

Billboard/City light do të përmbajnë informacion thirrje për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kryetar Bashkie në ato bashki ku do të mbahen zgjedhjet e pjesshme.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

